

UDHËZIM
Nr. 1, datë 13.1.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 17, DATË 31.7.2012 “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013” DHE UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 14, DATË 9.7.2013 “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË KËTO INSTITUCIONE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 112 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 3, germa “a” e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 31.7.2012, ndryshon si më poshtë:

“Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën; dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri; dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”, origjinali ose fotokopje të saj, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).”.

2. Në pikën 5 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 31.7.2012, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore dhe elektronike (në *hardcopy* dhe në CD), brenda datës 31 janar 2014, listën e kandidatëve të regjistruar në vitin akademik 2012-2013, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”. AKP-ja, brenda datës 28 shkurt 2014, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.”.

3. Pika 3, paragrafi i parë, i udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), ndryshon si më poshtë:

“Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme, si dhe është pajisur me diplomën përkatëse në Republikën e Shqipërisë, për të realizuar aplikimin, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:”.

4. Pika 3, germa “a” e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), ndryshon si më poshtë:

“Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje e noterizuar e diplomës, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).

Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar), paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinali ose fotokopje të saj të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).”.

Në qoftë se kandidatët nuk zotërojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.”.

5. Në pikën 9 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013 (të ndryshuar), shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore dhe elektronike (në *hardcopy* dhe në CD), brenda datës 31 janar 2014, listën e kandidatëve të regjistruar në vitin akademik 2012-2013, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike” (të ndryshuar)”. AKP-ja, brenda datës 28 shkurt 2014, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.”.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet private të arsimit të lartë.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla